



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 33/2011
Prishtinë, më 29.09.2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha- Shala, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani, Biserka Kostiq, Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Munguan: Hashim Deshishku dhe Berat Buzhala.

Pjesëmarrës të tjerë: Remzije Hajdari – MTI, Igballe Rexha-Jashari – MTI, Flamur Keça – MTI, Douglas Cruckshank – USAID BEEP, Berat Gajtani – USAID BEEP, Petrit Gashi – USAID BEEP, Ukë Gashi - ZPRK dhe Lejla Selimi – OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Brikena Hoxha, konsulente e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.09.2011;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-48 për Tregti me Jashtë;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë për emërim të një anëtari të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27 .09.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 27.09.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-48 për Tregti me Jashtë

Kryetari –Tha se për këtë projektligj amendamente ka sjellur USAID projekti BEEP, dhe këtë dokument e keni para jush. Kryetari ftoi përfaqësuesin e MTI-së të marrë fjalën dhe të paraqes pikpamjet e Ministrisë lidhur me amendamentet e propozuara nga BEEP.

Flamur Keça MTI – para antarëve të Komisionit theksoi se Ministria ka shqyrtuar propozim amendamentet e BEEP dhe pajtohet me ato propozime.

Lutfi Zharku – tha se ndryshimet janë të mëdha sipas amendamenteve të BEEP-it, dhe do të ishte mirë që Ministria të marrë projektligjin përsëri dhe ta sjellë atë në version më të kompletuar.

Kryetari – tha se për shkak të vëllimit të madh të amendamenteve, duke marrë parasysh edhe vlersimet e antarëve të Komisionit, mirë të formohet grup punues dhe më parë amendamentet të shqyrtohen në grup punues e mandej në Komision. Ne fund kërkoj që të formohet grupi punues për amendamentimin e projektligjit për tregti me jashtë.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

V E N D I M

1. *Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit nr.04/L-48 për tregti me jashtë;*
2. *Grupi punues ka këtë përbërje: Myzejene Selmani raportuese, Hashim Deshishku, Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi anëtarë;*
3. *Secili anëtarë i Komisionit sipas interesimit mund ti bashkëngjitet Grupit punues gjatë punës së tij;*
4. *Grupi punues në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë për emërim të një anëtari të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Kryetari – njoftoi antarët e Komisionit lidhur me propozimin e Qeverisë për antar të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Biserka Kostiq – tha se dokumentet e të propozuarve të Qeverisë për antarë të bordit përsëri janë vetëm në gjuhën shqipe dhe nuk e kupton gjuhën shqipe, dhe shtoi se dokumentet duhet të jenë edhe në gjuhën serbe. Në vazhdim deputetja Kostiq theksoi se në propozimin e Qeverisë nuk ka asnjë kandidat të propozuar nga komunitetet. Sipas Pakos së Ahtisarit, ajo tha se me 10% duhet të jenë të përfaqësuar komunitetet në të gjitha institucionet. Ajo tha se ka kuadro edhe nga komunitetet që do të mund të ishin antarë të Bordit. Ne vazhdim potencoi se nuk do ta mbështes

asnjë antarë sepse nuk ka përfaqësues nga komunitetet por vetëm nga ata shqiptar. Ajo propozoi të shtyhet kjo çështje për një mbledhje tjetër dhe duhet të ketë edhe kandidat nga komunitetet tjera. Në fund ajo tha se do ti propozoj grupit tim parlamentar të mos e mbështes këtë propozim në Kuvend.

Kryetari - theksoj se ky Komision nuk është për të caktuar kandidat nga komunitetet, dhe theksoi se është mirë kjo çështje të shqyrtohet në Qeveri dhe në Komisionin për komunitete.

Sala Berisha-Shala – theksoi se fusha e minierave dhe mineraleve më parë ka qenë e rregulluar me rregullore të UNMIK-ut, ndërsa tash është e rregulluar me ligj. Ajo sqaroi se konkursi ka qenë i hapur dhe ka mundur të konkurojë secili duke përfshirë të gjitha komunitetet.

Myzejene Selmani – tha se konkursi ka qenë i hapur dhe natyrisht se kanë mund të konkurojnë kandidat nga të gjitha komunitetet, dhe është e drejtë e secilit qytetar të Kosovës të konkurojë. Ajo në vazhdim propozoi që propozimi i Qeverisë të hedhet në votim dhe secili të votojë sipas bindjes së tij.

Pas debatit Komisioni me 7 vota për dhe 2 kundër nxori këtë

Rekomandim

Kuvendi i Kosovës të emërojë njërin nga të propozuarit e Qeverisë për anëtar të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, si vijon:

- *Naim Hyseni*
- *Ramiz Krasniqi*

4. Të ndryshme

a) Takimi me delegacionin Gjerman;

Kryetari – i njoftoi antarët e Komisionit se nesër me datë 30.09.2011 në ora 8:30 do të mbahet takim me një delegacion Gjerman i cili këto ditë po viziton Kosovën. Në këtë takim shtoi ai nga Komisioni do të marrin pjesë Kryetari i Komisionit dhe dy antarë. Ai kërkoi nga antarët e komisionit të caktohen dy antarë që do të marrin pjesë.

Pas konsultimeve Komisioni nxori këtë

Përfundim

Në takimin me delegacionin Gjerman do të marrin pjesë përveq Kryetarit edhe antaret Teuta Sahatqija dhe Sala Berisha-Shala.

b) Informate lidhur me përgatitjet për vizitë në Shqipëri;

Visar Ymeri – kërkoi të dijë se a ka diçka në lidhje me vizitën në Shqipëri, sepse kur ishte në vizitë Ministri Olldashi na ftoi të vizitojmë Shqipërinë.

Kryetari – njoftoi se jemi në bisedime me Ambasaden dhe janë duke e përgatitur vizitën kah fundi i Tetorit i këtij viti.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit